

URDHËR
Nr. 52, datë 30.1.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 247, DATË 28.7.2017, PËR
MIRATIMIN E TARIFAVE TË NJËSUARA TË SHËRBIMIT TË
DOKUMENTACIONIT NË RRJETIN ARKIVOR KOMBËTAR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11/“b”, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 24.6.2017, për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar;

URDHËROJ

1. Në urdhrin nr. 247, datë 28.7.2017, “Për miratimin e tarifave të njësuara të shërbimit të dokumentacionit në Rrjetin Arkivor Kombëtar të Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto shtesa:

- Në paragrafin “Tarifat e Posaçme”, pika II, “Restaurimi i dokumenteve nga Laboratori i Restaurimit” bëhet “Restaurimi i dokumenteve, testimi i letrës dhe i kartonit nga Laboratori Qendror i Restaurimit”, si dhe shtohen tarifat për testimin e letrës dhe kartonit, si më poshtë:

- Matja e densitetit 1500 lekë;
- Matja e trashësisë 1500 lekë;
- Matja e volumit specifik 1500 lekë;
- Matja e gramaturës 1500 lekë;
- Matja e pH 1000 lekë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido